Politika për privatësinë për përdorimin e SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR të VOLKSWAGEN AG "We Connect", "VW Connect" në automjetet e familjes ID., si dhe në Amarok (duke filluar nga modeli i vitit 2023) dhe Transporter (duke filluar nga modeli i vitit 2025)

(Versioni: gusht 2026 – Politika për privatësinë përditësohet rregullisht. Versioni aktual gjendet gjithmonë online në https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/WeConnect/al/sq/dataprivacy/latest/html.)

Kjo politikë për privatësinë informon rreth përpunimit të të dhënave personale në kuadër të përdorimit të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR "We Connect, VW Connect" (në vijim këto referohen të përmbledhura te "**VW Connect**") në automjetet e "familjes ID." të Volkswagen AG. Politika për privatësinë për përdorimin e automjeteve të "familjes ID.", gjendet në seksionin "Informacione ligjore" ose online në adresën https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/WeConnect/al/sq/dataprivacycar/latest/html.

Si kompani gjermane, Volkswagen AG është e detyruar të respektojë ligjin gjerman dhe Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, "Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/KE (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave) ("**GDPR**"). Kjo ndodh edhe kur Volkswagen AG përpunon të dhëna personale nga persona me vendbanim të qëndrueshëm jashtë Gjermanisë. Informacionet e nevojshme sipas ligjit gjerman dhe GDPR rreth përpunimit të të dhënave të rëndësishme, i gjeni te **Pjesa I** e kësaj politike për privatësinë.

Gjithashtu, Volkswagen AG mund të jetë e detyruar të respektojë, deri në një masë të caktuar, edhe ligjet kombëtare të vendeve të tjera. Personat me vendbanim të qëndrueshëm në një nga vendet e përmendura te **Pjesa II** e kësaj politike për privatësinë, do të gjejnë aty informacionet shtesë.

Përmbajtja:

Pjesa I

A. Kontrolluesi për përpunimin e të dhënave

B. Personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave, personi i kontaktit

C. Të drejtat tuaja
I. E drejta për informim
II. E drejta për korrigjim
III. E drejta për fshirje
IV. E drejta për kufizimin e përpunimit
V. E DREJTA PËR KUNDËRSHTIM
VI. E drejta për transmetimin e të dhënave

VII. E drejta e revokimit
VIII. E drejta e ankimit

D. Përshkrimi i përpunimit të të dhënave
I. Qëllimet e përpunimit të të dhënave
II. Marrësit e të dhënave
III. Fshirja dhe korrigjimi i të dhënave personale

E. Përpunimi i të dhënave në detaje
I. Volkswagen ID
II. Volkswagen Ident

F. Portofoli i shërbimeve "VW Connect" në automjetet e "familjes ID."

Pjesa II

Pjesa I

A. Kontrolluesi për përpunimin e të dhënave

Përgjegjësi për përpunimin e të dhënave personale është Volkswagen AG (më poshtë "ne" ose "neve").

Volkswagen AG mund ta kontaktoni në:

Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg
Gjermani
Tel.: +49-5361-9-0
connect-support@volkswagen.de

Numri në Regjistrin Tregtar HRB 100484 (Gjykata e Shkallës së Parë Braunschweig)

B. Personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave, personi i kontaktit

Zyrtari ynë për mbrojtjen e të dhënave është në dispozicion si partner kontakti për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave si dhe për ushtrimin e të drejtave tuaja përkatëse (krahaso paragrafin C "Të drejtat tuaja").

Ju lutemi që t'i drejtoni kërkesat te:

Datenschutzbeauftragter der Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg
Gjermani
dataprivacy@volkswagen.de

Për ushtrimin e të drejtave përkatëse mund të përdoret edhe adresa e emailit info-datenschutz@volkswagen.de (Gjermani) dhe privacy@volkswagen.de (jashtë Gjermanisë) ose portali ynë i mbrojtjes së të dhënave të Volkswagen https://www.datenschutz.volkswagen.de.

C. Të drejtat tuaja

Ju mund të kërkoni të drejtat e mëposhtme nga Volkswagen AG në çdo kohë dhe falas.

Mbani parasysh që ne nuk e identifikojmë përdoruesin përkatës të automjetit, nëse nuk ekziston asnjë koncept i përdoruesit (i disponueshëm vetëm në varësi të modelit dhe pajisjes) ose nëse ju e përdorni automjetin si vizitor. Për rrjedhojë, në rastin kur ka disa përdorues të automjetit ne nuk mund ta dallojmë se cilit drejtues të mjetit u referohen të dhënat personale. Nëse kërkoni të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave, ne duhet të verifikojmë identitetin tuaj dhe, nëse është e nevojshme, mund t'ju kërkojmë informacione ose shpjegime të tjera (veçanërisht informacione për periudhën ose kushtet e tjera të përdorimit të automjetit). Këto informacione shtesë mund t'i kërkojmë për t'ju identifikuar ju me të dhënat tuaja personale dhe për t'jua vënë ato në dispozicion. Duhet të garantojmë gjithashtu që të mos shkelen të drejtat e përdoruesve të tjerë të automjetit gjatë zbulimit të të dhënave personale.

Më shumë informacione për mbrojtjen e të drejtave tuaja gjeni në faqen e internetit https://datenschutz.volkswagen.de/.

I. E drejta për informim

Ju keni të drejtën të kërkoni nga ne një konfirmim nëse do të përpunohen të dhënat personale dhe – në rast se po – cilat prej tyre dhe cilave palë të treta brenda dhe jashtë BE-së do t'u përcillen të dhënat tuaja. Keni gjithashtu të drejtën të merrni nga ne një kopje të të dhënave tuaja personale të përpunuara prej nesh.

II. E drejta për korrigjim

Ju keni të drejtën të kërkoni nga ne korrigjimin e të dhënave tuaja personale nëse janë të pasakta ose të paplota.

III. E drejta për fshirje

Ju keni të drejtën të kërkoni fshirjen e të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet e përmendura në nenin 17 të GDPR. Më pas, ju keni të drejtën, për shembull, të kërkoni fshirjen e të dhënave tuaja, për aq kohë sa ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Përveç kësaj, mund të kërkoni fshirjen, nëse të dhënat tuaja i përpunojmë në bazë të dhënies së pëlqimit tuaj dhe ju e revokoni këtë pëlqim.

IV. E drejta për kufizimin e përpunimit

Ju keni të drejtën të kërkoni kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet e nenit 18 të GDPR. Ky për shembull është rasti, nëse kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja. Për kohëzgjatjen e verifikimit të saktësisë së të dhënave personale, mund të kërkoni kufizimin e përpunimit.

V. E DREJTA PËR KUNDËRSHTIM

Ju keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në rastet e mëposhtme:

- **Nëse përpunimi bëhet për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë (duke përfshirë profilizimin për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë).**

- **Nëse përpunimi (duke përfshirë profilizimin) mbështetet në një nga bazat e mëposhtme ligjore:**

    - **Përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e një procesi që ka interes publik ose për ushtrimin e autoritetit publik që na është ngarkuar (neni 6, paragrafi 1, germa "e" e GDPR).**

    - **Përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave legjitime nga ne ose palë e tretë (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR). Në rastin e një kundërshtie të tillë, ju lutemi të ndani me ne arsyet, për të cilat kundërshtoni përpunimin e të dhënave. Ne nuk i përpunojmë më të dhënat tuaja në rastin e kundërshtimit tuaj, në qoftë se ne mund të tregojmë arsyet detyruese mbrojtëse për përpunimin, të cilat tejkalojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja, ose nëse përpunimi i shërben zbatimit, ushtrimit ose mbrojtjes së pretendimeve ligjore.**

VI. E drejta për transmetimin e të dhënave

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në dhënien e pëlqimit tuaj ose në zbatimin e një kontrate dhe nëse kjo bëhet përmes një metode përpunimi të automatizuar, atëherë ju keni të drejtën t'i merrni të dhënat tuaja në një format të strukturuar, të zakonshëm dhe të lexueshëm nga pajisjet kompjuterike, si dhe t'ia transferoni ato një organi tjetër përgjegjës. Përveç kësaj, keni të drejtën të kërkoni që të dhënat personale të transferohen direkt nga ne në një organ tjetër përgjegjës.

VII. E drejta e revokimit

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në dhënien e pëlqimit, ju keni të drejtën ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo moment pa pagesë, me efekt në të ardhmen, përmes emailit tek info-datenschutz@volkswagen.de (Gjermani), privacy@volkswagen.de (jashtë Gjermanisë), përmes portalit tonë të mbrojtjes së të dhënave të Volkswagen https://www.datenschutz.volkswagen.de ose duke kontaktuar në të dhënat e kontaktit tek "Të dhënat e botimit".

VIII. E drejta e ankimit

Ju keni gjithashtu të drejtën të paraqisni një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës ose autoriteteve të tjera kompetente për mbrojtjen e të dhënave, lidhur me përpunimin që ne u bëjmë të dhënave tuaja. Ky mund të jetë, për shembull, autoriteti për mbrojtjen e të dhënave në vendin ku banoni. Një listë me të gjitha autoritetet për mbrojtjen e të dhënave në Bashkimin Evropian dhe Zonën Ekonomike Evropiane e gjeni këtu: https://edpb.europa.eu/about-edpb/about-edpb/members_en#member-al.

D. Përshkrimi i përpunimit të të dhënave

Ky seksion përshkruan procedurat për përpunimin e të dhënave për aktivizimin dhe përdorimin e SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR "VW Connect" në automjetet e "familjes ID.". Gjatë përdorimit

të automjetit, ju lutemi të kini parasysh edhe politikën për privatësinë për automjetet e "familjes ID.", që mund të shihet në automjet te seksioni "Informacione ligjore" ose online në adresën https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/WeConnect/al/sq/dataprivacycar/latest/html.

I. Qëllimet e përpunimit të të dhënave

1. Përpunimi i të dhënave për qëllimin e lidhjes së kontratës dhe zgjatjen e kontratës, koncepti i përdoruesit

a) Aktivizimi i "VW Connect" për një automjet

Në mënyrë që shërbimet "VW Connect" të jenë në dispozicion në automjet, automjeti duhet të lidhet te cilësimet me "VW Connect" ("**Aktivizimi**"). Për këtë qëllim nevojitet krijimi i një llogarie qendrore të përdoruesit - "Volkswagen ID" - si dhe aplikacioni për celular "Volkswagen" ("**Aplikacioni**").

Ju lutemi të respektoni politikat përkatëse për privatësinë së "Volkswagen ID" dhe aplikacionit, që mund të shihen online në adresën https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/identitykit/de/sq/volkswagen-dataprivacy/latest/html und https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/WeConnectID/al/sq-al/dataPrivacy/latest/html.

Përveç kësaj, gjatë aktivizimit të shërbimeve përpunohen të dhënat e mëposhtme:

Mbiemri, emri, adresa e emailit, fjalëkalimi, numri i identifikimit të automjetit (VIN), pseudonimi, kodi S-PIN, vendbanimi, gjuha e preferuar, ID e përdoruesit, momenti i porosisë (Start Timer 72 orë), momenti i aktivizimit, datëlindja, (për VW Ident), të dhënat e përdorimit të IT.

Pas aktivizimit me sukses të shërbimeve për automjetin, klienti i "VW Connect" është përdoruesi kryesor dhe mund t'i përdorë shërbimet direkt si në automjet, ashtu edhe në aplikacion ose përmes një fushe personale të hyrjes në shfletuesin e internetit në adresën www.myvolkswagen.de . Çdo herë që regjistrohet në automjet përdoruesi kryesor, përpunohen gjithashtu edhe të dhënat e mëposhtme:

Numri i identifikimit të automjetit (VIN), identifikimi ndërkombëtar i pajisjeve celulare ("IMEI"), adresa e emailit, emri i përdoruesit, fjalëkalimi, kodi S-PIN, fotografia e profilit.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave është përmbushja e kontratës së "VW Connect" (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

b) Bëhu përdorues (dikur përdorues vizitor i regjistruar)

Në varësi të modelit dhe pajisjes, gjatë përdorimit të "VW Connect" është në dispozicion edhe roli i përdoruesit "Përdorues", nëse automjeti përkatës disponon tashmë një përdorues kryesor. Ndërkohë që roli i përdoruesit "Përdorues kryesor" është parashikuar për përdoruesin kryesor të automjetit dhe mund të merret vetëm nga një person, një automjet mund të përdoret nga disa përdorues. Për këtë qëllim, përdoruesi përkatës mund të regjistrohet vetë në automjet me "Volkswagen ID" e tij. Për këtë, ai prek në pamjen e përgjithshme të përdoruesve në sistemin e informimit dhe argëtimit të automjetit në shenjën "Plus" dhe vendos një profil "VW Connect" ("**Profili**"). Pas kësaj, cilësimet e tilla si cilësimet e privatësisë ruhen në profilin e përdoruesit përkatës dhe nuk duhet të kryhen përsëri gjatë çdo përdorimi të automjetit.

Në rastin e regjistrimit dhe për çdo identifikim në automjet si përdorues përpunohen të dhënat e mëposhtme:

Numri i identifikimit të automjetit (VIN), identifikimi ndërkombëtar i pajisjeve celulare ("IMEI"), adresa e emailit, emri i përdoruesit, fjalëkalimi, S-PIN, fotografia e profilit, roli i përdoruesit.

Përdoruesi kryesor mund të shohë pseudonimin, emrin dhe mbiemrin dhe foton e profilit të përdoruesit në fushën e tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit dhe/ose në aplikacionin "Volkswagen".

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave është përmbushja e kontratës së "VW Connect" (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

Gjithashtu, ju lutemi të mbani parasysh politikën për privatësinë së "Volkswagen ID", që mund të thërritet online në https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/identitykit/de/sq/volkswagen-dataprivacy/latest/html.

Për përdoruesit janë në dispozicion vetëm SHËRBIME të caktuara ONLINE ME CELULAR (shihni Pjesa I F. Portofoli i shërbimeve).

Duhet bërë dallimi midis përdoruesit dhe "vizitorit", që do të thotë një nga përdoruesit e panjohur të automjetit të Volkswagen AG. Përdoruesit e automjetit, të cilët nuk duan të vendosin një profil personal në automjet, mund të përdorin profilin "Vizitor" gjatë zgjedhjes së përdoruesit në sistemin e informimit dhe argëtimit (i disponueshëm në varësi të modelit dhe pajisjes). Këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë profil të personalizuar. Krijimi i një Volkswagen ID ose lidhja e një kontrate për "VW Connect" nuk është e nevojshme. Për aq kohë sa vizitori e përdor automjetin në modalitetin online, ai ka në dispozicion pak SHËRBIME të zgjedhura ONLINE ME CELULAR. Pas përfundimit të udhëtimit, cilësimet e privatësisë në këtë profil rikthehen në gjendjen fillestare dhe automjeti kalon përsëri në modalitetin offline.

2. Përpunimi i të dhënave për qëllimin e ofrimit të shërbimeve

a) Përdorimi i shërbimeve

Gjatë përdorimit të "VW Connect" përpunohen ato të dhëna personale (në veçanti të dhënat e përdorimit të automjetit), të cilat nevojiten për ofrimin e shërbimeve përkatëse. Për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin, përpunimi i të dhënave bëhet për zbatimin e kontratës (neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR). Për të gjithë përdoruesit e tjerë të automjetit, duke përfshirë vizitorin, përpunimi i të dhënave bëhet për interesin tonë legjitim, për ofrimin e shërbimeve sipas kontratës së "VW Connect" të lidhur për automjetin (neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR), nëse automjeti përdoret online. Përshkrimin e roleve të përdoruesve e gjeni në paragrafin D.I.1.

Gjatë përdorimit, përpunohen në çdo rast numri i identifikimit të automjetit (VIN) dhe adresa IP. Përveç kësaj, përpunohet ID e përdoruesit për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin aktual, roli i tij, si dhe informacionet për modelin e automjetit dhe pajisjen e tij, për të verifikuar se cilat produkte të "VW Connect" janë aktivizuar për automjetin nga një përdorues kryesor dhe që mund të përdoren nga drejtuesi përkatës i mjetit. Përveç kësaj, se cilat të dhëna personale përpunohen, i merrni në pjesën E "Portofoli i shërbimeve".

Përveç shërbimeve kontraktuale/të aktivizuara si opsion, mund të ekzistojnë edhe përpunime të dhënash të detyrueshme me ligj (p.sh. thirrja ligjore e emergjencës ose njoftimet zyrtare të detyrueshme të automjeteve), të cilat nuk i nënshtrohen komandimit nga ana e përdoruesit dhe bazohen te neni 6, parag. 1, germa "c" e GDPR.

b) Eliminimi i gabimeve dhe siguria

Përveç numrit VIN dhe kodit ID të përdoruesit kryesor, ne protokollojmë edhe kohën dhe llojin e një shërbimi të përdorur, për të identifikuar dhe analizuar defektet dhe kërcënimet e sigurisë. Kjo bëhet për ruajtjen e interesave tona legjitime, në kuadër të përmirësimit të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR si dhe për të garantuar sigurinë IT për SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR, për t'ua ofruar ato të gjithë klientëve tanë mundësisht pa probleme (Neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR).

Në rastin e një defekti të identifikuar, Volkswagen AG përpunon të dhënat e kontaktit të përdoruesve të regjistruar, për t'i kontaktuar nëse nevojitet. Përpunimi bëhet në kuadër të zbatimit të kontratës (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

c) Kufizimi i përpunimit të të dhënave (cilësimet e privatësisë)

Në automjet janë në dispozicion cilësime të ndryshme të privatësisë (shihni "Politika për privatësinë për automjetet e familjes Volkswagen ID."). Sipas rastit, në varësi të cilësimit, SHËRBIME të caktuara ONLINE ME CELULAR nuk janë më të përdorshme pavarësisht përdoruesit.

Gjithashtu, SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR mund të aktivizohen dhe të çaktivizohen individualisht nga përdoruesi kryesor dhe përdoruesi përmes fushës së tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacionin e tij ("**Menaxhimi i shërbimeve**"). Ky menaxhim i shërbimeve është i lidhur me përdoruesin dhe përshtatet vetëm në pamjen e aplikacionit/uebit të përdoruesit përkatës.

d) Bllokimi i kodit S-PIN nëpërmjet futjes së gabuar të të dhënave

Për mbrojtjen e të dhënave tuaja si për shembull cilësimet personale ose aksesi në shërbime të tjera profili i përdoruesit në automjet mbrohet nëpërmjet një kodi S-PIN. Nëse kodi S-PIN futet disa herë me gabime, atëherë të dhënat e futura bllokohen përkohësisht. Bllokimi i përkohshëm i kodit S-PIN është ndonjëherë në mënyrë dinamike. Kjo nënkupton, që kohëzgjatja aktuale e bllokimit nuk mund të përcaktohet nga kohëzgjatja e mëparshme e bllokimit.

e) Mosveprimi i përdorimit të shërbimeve

Nëse përdoruesi kryesor ose përdoruesi nuk përdor asnjë SHËRBIM ONLINE ME CELULAR nëpërmjet fushës së tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacionin e tij brenda 30 ditëve, atëherë aktivizohet e ashtuquajtura "Data Saving Mode". Këtu përpunohen numri i identifikimit të automjetit (VIN) dhe kërkesa e fundit për automjetin. Të dhënat për autonominë e mbetur dhe proceset e karikimit dhe statusi i dyerve/kapakëve/xhamave si dhe njoftimi push përkatës "Automjet i parkuar në mënyrë të pasigurt" nuk do të transmetohen më nga automjeti në fushën personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacion. Sapo përdoruesi kryesor ose përdoruesi të jetë përsëri aktiv në fushën e tij personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacionin e tij, të dhënat transferohen përsëri. Kjo bëhet për ruajtjen e interesave tona legjitime, për të kursyer transferimin e të dhënave të panevojshme, për t'ua ofruar SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR të gjithë klientëve tanë mundësisht pa probleme (Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR). Të dhënat për përdorimin e fundit regjistrohen pas hyrjes në fushën personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose në aplikacion dhe fshihen më së shumti pas 30 ditësh.

3. Përpunimi i të dhënave në Customer Interaction Center (shërbimi i klientit)

Ekziston mundësia që t'i drejtoheni Customer Interaction Center ("CIC") për çështje në lidhje me aplikacionet, shërbimet dhe faqet e internetit të Volkswagen AG (p.sh. me postë, email, formular kontakti ose telefon). Këtu Volkswagen AG i përpunon të dhënat personale (p.sh. emrin, adresën e emailit, adresën, numrin e telefonit, vendin dhe gjuhën), të cilat nevojiten për t'iu përgjigjur kërkesave dhe për shërbimin e klientit. Informacione të tjera për mbrojtjen e të dhënave gjatë

përdorimit të CIC mund të thirren në politikën për privatësinë së CIC në adresën https://cic-legal.volkswagen.com.

Nëse është e nevojshme për realizimin e kontratës për "VW Connect", CIC mund të kontaktojë me secilin klient. Për këtë qëllim ne i përpunojmë të dhënat e kontaktit të regjistruara te ne, për qëllimet e zbatimit të kontratës (neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR).

4. Këshillimi dhe shërbimi i klientit (partneri i servisit / shitësi)

Për një shërbim të orientuar ndaj klientit në kuadër të shërbimeve tona ONLINE ME CELULAR ju mund të kontaktoni partnerin tuaj Volkswagen (partnerin e servisit dhe/ose shitësin), i cili pranon në këtë kontekst shërbimin e klientit për Volkswagen AG. Për më tepër, të dhënat e mëposhtme transferohen ndër të tjera te partneri i Volkswagen dhe përpunohen nga ai si përpunues i kërkesave: Të dhënat e kontratës, mbiemri, emri, Volkswagen ID (emaili), VIN dhe të dhënat e automjetit, statusi i verifikimit, statusi i përdoruesit (përdoruesi kryesor po/jo), planifikimi i datave të servisit (shërbimi aktiv/ jo aktiv), partneri i preferuar i servisit (shërbimi i zgjedhur/jo i zgjedhur) si dhe të dhëna të tjera, të cilat na i vini në dispozicion në kuadër të kërkesës suaj. Të dhënat i përpunojmë sipas nenit 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për zbatimin e kontratës nëpërmjet SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR ose – nëse nuk jeni klient – për lidhjen e një kontrate nëpërmjet përdorimit të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR.

Marrës të tjerë: Audi AG, Auto-Union-Straße 1, 85057 Ingolstadt, Gjermani, si ofrues i shërbimit teknik (Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

5. Krijimi i vlerësimeve për menaxhimin e kompanisë

Volkswagen AG përpiqet vazhdimisht për të përmirësuar ecuritë e proceseve të biznesit në kuadër të menaxhimit të kompanisë si dhe për të optimizuar kostot përkatëse. Për këtë është e nevojshme një analizë e thellë e të dhënave të analizës online, të ofertës, shitjes dhe porosisë. Për këtë arsye Volkswagen AG i përpunon të dhënat nga sistemet e analizës online, të ofertës, shitjes dhe porosisë si dhe të dhënat nga shërbimet e lidhura me Volkswagen ID. Detajet për këtë përpunim të dhënash (p.sh. se cilat të dhëna përpunohen me sa saktësi) gjeni në politikën për privatësinë të Volkswagen ID në adresën https://vwid.vwgroup.io/data-privacy.

6. Përpunimi për qëllim reklamimi dhe komunikimi kontraktual i Volkswagen AG

Volkswagen AG përpiqet vazhdimisht t'i sigurojë gjithmonë klientëve informacione të personalizuara për ta personalisht, në mënyrë që të përmirësohet reklamimi për shitjen e produkteve dhe shërbimeve tuaja. Për më tepër, është e nevojshme një analizë e thellë e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve tona. Prandaj, nëse përdoruesi e ka dhënë pëlqimin e tij, Volkswagen AG i përpunon të dhënat nga llogaria e përdoruesit Volkswagen ID, si dhe nga "VW Connect". Të dhënat përdoren gjithashtu për të kontaktuar përdoruesin si pjesë e komunikimit kontraktual (p.sh. në rastin e kontratave që skadojnë). Detajet për këtë përpunim të të dhënave (p. sh. se cilat të dhëna përpunohen me sa saktësi) duhen gjetur në politikën për privatësinë të Volkswagen ID në adresën https://vwid.vwgroup.io/data-privacy.

7. Analiza e produkteve dhe shërbimeve

Udhëzim: Paragrafi "Analiza për përmirësimin e produkteve" vlen vetëm për klientët në Gjermani, Austri, Danimarkë, Francë, Spanjë, Itali, Irlandë, Mbretëri e Bashkuar, (duke përfshirë Irlandën e Veriut), Zvicër, Holandë, Belgjikë, Norvegji dhe Suedi.

Volkswagen AG përpiqet në vazhdimësi të zhvillojë produkte dhe shërbime të reja, si dhe të përmirësojë ato ekzistuese. Për arritjen e këtij qëllimi nevojitet një analizë e thellë e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve (analitika). Për këtë arsye, Volkswagen AG i përpunon të dhënat nga llogaria e përdoruesit të Volkswagen ID dhe nga "VW Connect", si p.sh.

- Të dhënat e identifikimit pseudonim (p.sh. një identifikim pseudonim i përdoruesit i gjeneruar në mënyrë rastësore)
- Të dhënat e përdorimit të automjetit (p.sh. të dhënat e ngarkimit, të udhëtimit dhe të parkimit, cilësimet e ngarkimit dhe të kohëmatësit)
- Të dhënat kontraktuale (p.sh. pajimi i automjetit, si madhësia e baterive)
- Të dhënat e përdorimit të IT (p.sh. ID e përdoruesit, përdorimi i shërbimeve "VW Connect")
- Të dhënat e vendndodhjes (p.sh. të dhëna të shkurtuara të GPS, pikat e karikimit)
- Të dhënat mbi gjendjen e automjetit (p.sh. intervalet e servisit, paralajmërimet e shfaqura, dritat paralajmëruese të aktivizuara)

Në rastin e depozitimit të automjeteve në llogarinë e përdoruesit të Volkswagen ID, Volkswagen AG përpunon numrin e identifikimit të automjetit dhe i pasuron të dhënat e lartpërmendura bashkë me të dhënat e tjera të pajimeve të automjetit përkatës. Gjatë përpunimit, të dhënat personale pseudonimizohen. Pseudonimizimi nënkupton heqjen e të gjithë elementeve që e identifikojnë drejtpërdrejt personin tuaj (p.sh. numri i identifikimit të automjetit). Do të mbahen elementët që ju identifikojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (pseudonimi). Për më tepër, ne i shkurtojmë të dhënat e GPS. Vetëm në përfundim të këtij pseudonimizimi dhe shkurtimi, të dhënat do të analizohen në sistemet analitike të Volkswagen AG.

Përpunimi i të dhënave të pseudonimizuara (p.sh. kodi ID i përdoruesit, numri i pseudonimizuar i identifikimit të automjetit) është i nevojshëm, për të përcaktuar ndikime afatgjata të ndërveprimi midis përdorimit të automjetit dhe të shërbimeve të klientëve tanë dhe gjendjes së automjetit (p. sh. kapaciteti funksional i baterive). Për më tepër, vlerësimet e automjeteve dhe modeleve të ndërthurura bëhen të mundura, veçanërisht për analizimin e ndryshimeve midis modeleve të automjeteve dhe specifikimeve të automjeteve. Vetëm në këtë mënyrë mund të identifikojmë masa të reja dhe të mëtejshme zhvillimore dhe t'u ofrojmë klientëve tanë produkte dhe shërbime të reja e të përmirësuara.

Për më tepër, analiza e këtyre të dhënave lejon një vlerësim të gjendjes së automjetit, siç është gjendja e baterisë së tensionit të lartë. Informacioni rreth gjendjes së automjetit është i rëndësishëm, për shembull, në kontekstin e shitjes së automjeteve të përdorura.

Për analizat në lidhje me karikimin përpunohen për një kohë të shkurtër të dhënat e shkurtuara GPS, për të përcaktuar pikat e karikimit. Të dhënat teknike për këto pika karikimi thirren nga burime të jashtme.

Informacioni se ku është karikuar një automjet, ruhet pa iu referuar një numri të identifikimit të automjetit dhe një përdoruesi. Në këtë mënyrë nuk krijohen profilet e lëvizjet ose të përdorimit. Qëllimi i përpunimit është vetëm analiza teknike, p.sh. cilat lloje automjetesh kanë probleme me karikimin në cilat pika karikimi.

Vetëm të dhënat personale të përdoruesit kryesor do të përpunohen dhe vetëm në masën që shërbimet përkatëse nga portofoli i shërbimit të aktivizohen dhe përdoren. Për aq kohë sa përdoruesit aktivizojnë dhe përdorin shërbimet e vendosura në dispozicion nga përdoruesi kryesor, të dhënat e automjetit që krijohen nga përdorimi i caktohen përdoruesit kryesor. (krahaso paragrafi E. Portofoli i shërbimit "VW Connect" në automjetet e "familjes ID."). Përveç kësaj,

përdoruesit e automjetit mund të kryejnë rregullime individuale te cilësimet e privatësisë dhe kështu të kontrollojnë se cila të dhëna duhet të dalin nga automjeti (krahaso paragrafi D.I.2.c) "Kufizimi i përpunimit të të dhënave (cilësimet e privatësisë)").

Përpunimi i përshkruar i të dhënave bëhet për interesat legjitime të Volkswagen AG, për t'u ofruar klientëve tanë produkte dhe shërbime të reja, të zhvilluara dhe të përmirësuara (Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR).

Volkswagen AG fshin çdo të dhënë të pseudonimizuar më së shumti pas 7 vjetësh ose sipas kërkesave ligjore, për shembull sapo përmbushet qëllimit për të cilin ato janë mbledhur, dhe për aq kohë sa nuk ka asnjë detyrim ruajtjeje që të pengojë fshirjen e tyre.

Marrës të tjerë të të dhënave: CARIAD dhe Volkswagen Group Info Services AG ("GIS"), të dyja Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani (këta marrës përpunojnë të dhëna personale vetëm me porosi dhe sipas specifikimeve të Volkswagen AG).

Ne gjithashtu ndajmë rezultatet e analizave, veçanërisht informacionin mbi gjendjen e automjetit, me GIS, kontrolluesin e të dhënave. GIS përdor këto të dhëna për të promovuar shitjet e automjeteve: Informacioni transparent mbi gjendjen e automjetit siguron vlerën e automjeteve, ndërton besim dhe promovon blerjen dhe shitjen e automjeteve, duke i shërbyer kështu interesave legjitime të klientëve, tregtarëve dhe prodhuesve të automjeteve (Neni 6 (1) (f) i GDPR). GIS ofron informacion të mëtejshëm mbi përpunimin e të dhënave në faqen e saj të internetit www.drivesomethinggreater.com/service/Privacy-policy.

8. Shërbimi i të dhënave për stacionet e karikimit

Për aq kohë sa përdorni shërbimet "Karikimi", "Pozicioni i parkimit" (me saktësi metrike) si dhe "Kohët e nisjes", ne përpunojmë gjithashtu të dhënat e mbledhura në kuadër të ofrimit të shërbimit në një mënyrë të tillë, që t'i anonimizojmë ato plotësisht dhe më pas të vlerësojmë të dhënat e anonimizuara, në mënyrë që të marrim informacione faktike në lidhje me infrastrukturën e disponueshme të karikimit (në veçanti në lidhje me vendndodhjen dhe pajisjet e stacioneve të karikimit) dhe në bazë të tyre për t'u ofruar përdoruesve tanë të VW Connect funksionin "Shërbimi i të dhënave për stacionet e karikimit".

Me ndihmë të këtij funksioni "Shërbimi i të dhënave për stacionet e karikimit" shfaqen informacione të detajuara për stacionet publike të karikimit, të cilat ua lehtësojnë përdoruesve tanë planifikimin dhe kryerjen e proceseve të tyre të karikimit: Vendi i saktë dhe numri i pikave ekzistuese të karikimit, statusi i tyre aktual i zënies dhe i ngarkimit, si dhe disponueshmëria e parashikuar, defektet ekzistuese aktuale ose papërputhshmëritë për automjetin, llojet e disponueshme të spinës dhe fuqitë e parashikuara të karikimit si dhe oraret e karikimit dhe oraret e hapjes dhe të aksesit. Këto informacione janë të lexueshme në automjet, si dhe në aplikacionin Volkswagen.

Për aq kohë sa e përdorni automjetin në modalitetin offline, nuk mblidhen të dhëna dhe përcillen te Backend (as për ofrimin e shërbimeve "Karikimi", "Pozicioni i parkimit" dhe "Kohët e nisjes" as për ofrimin e funksionit "Shërbimi i të dhënave për stacionet e karikimit"). Modaliteti offline mund të konfigurohet në automjet.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN); pozicioni i parkimit; vula e kohës; fuqia faktike e kolonës së karikimit; lloji i rrymës (AC ose DC); statusi i spinës së spinës së karikimit; lloji i përdorur i spinës; kufiri i vendosur i karikimit; Timer Charging; gjendja e karikimit (SOC); informacionet për periudhën e procesit të karikimit; arsyeja e përfundimit të karikimit

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për anonimizimin e të dhënave: Interesi legjitim i Volkswagen AG është në zbatimin e parimit të minimizimit të të dhënave (neni 5, parag. 1, germa "c" e GDPR) dhe në marrjen e informacioneve faktike të anonimizuara për infrastrukturën e karikimit për vlerësimin e mëtejshëm, në veçanti për ofrimin e funksionit "Shërbimi i të dhënave për stacionet e karikimit" tek të gjithë përdoruesit VW Connect.

Marrës të tjerë të të dhënave: CARIAD SE, Major-Hirst-Straße 7, 38442 Wolfsburg, Gjermani (Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosi dhe sipas specifikime të Volkswagen AG).

9. Përpunimi i të dhënave për qëllimin e raportimeve të brendshme të kompanisë (Business Reporting)

Në kuadër të raportimeve të brendshme të kompanisë (Business Reporting) përpunohen të dhënat për menaxhimin e modelit të biznesit të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR dhe për përmirësimin e përvojës së klientit. Këtu ne përpunojmë të dhënat, të cilat përdoren për produktet dixhitale të blera si dhe shërbimet në automjet. Pasi vlerësohen, të dhënat vihen në dispozicion të departamenteve kompetente të Volkswagen AG vetëm brenda masës së nevojshme për qëllimin përkatës.

Për këtë përpunohen të dhënat personale të mëposhtme:

- Të dhënat personale të kontaktit dhe të identifikimit (p.sh.: ID e përdoruesit)
- Të dhënat e automjetit (p.sh. numri i identifikimit të automjetit (VIN), pajisja e automjetit, vendi i dorëzimit (importuesi))
- Të dhënat e kontratës (p.sh. lloji i klientëve (klient privat ose tregtar), ID e klientit, data e kontratës, historiku i klientit (p.sh. interesat e kontratës pa përfundim, konkluzionet, pagesat, rimbursimet, shpërblimet, paralajmërimet, anulimet), ankesat e klientëve, informacionet për produktet e blera (numri i artikullit, statusi i aktivizimit, data e aktivizimit, kohëzgjatja, vendi i zgjedhur gjatë regjistrimit, mënyra e pagesës), statusi i deklaratës së miratimit të marketingut, të dhënat e licencës, (ose licencat e blera, data e mbarimit))
- Të dhënat e përdorimit të IT (p.sh. ID e përdoruesit, informacionet për skedarët e evidencave rreth thirrjeve të shërbimit, adresat IP)
- Të dhënat e përdorimit të automjetit me kodin VIN/targat e automjetit, të cilat janë të rëndësishme në lidhje me garancinë, sigurimin, përgjegjësinë për produktin ose funksionimin e sigurt të automjetit (p.sh. vendi i dorëzimit, numri i identifikimit të automjetit, të dhënat e dorëzimit, pajimet)

Përpunimi bëhet për këto qëllime:

- Analiza për kontrollin e shitjeve dhe përmirësimi i produktit
  Ne përpunojmë të dhënat, për të kontrolluar shitjet, për të zhvilluar produktet dhe shërbimet e reja dhe për t'i përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme, duke analizuar normat e pranimit dhe indikatorët e rëndësishëm të performancës (KPIs). Analizat përkatëse përfshijnë gjurmimin e numrit të automjeteve të prodhuara, të dorëzuara dhe të regjistruara dhe licencat përkatëse të produktit si dhe llogaritjen e tarifave të regjistrimit dhe rinovimit.
  Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të vlerësuar normat e pranimit të produkteve/shërbimeve të reja dhe për të vlerësuar normat e pranimit të produkteve/shërbimeve ekzistuese.

- Kontabiliteti
  Për qëllimet e kontabilitetit, për identifikimin e gabimeve dhe për menaxhimin e rrezikut ne krahasojmë ofertat e Volkswagen Connect Shop me blerjet dhe faturat faktike të ofruesve të

shërbimit të pagesës. Gjithashtu, si masë për kontrollin e cilësisë analizohen informacionet e licencës dhe transaksionet e E-Commerce, për të korrigjuar gabimet dhe për të minimizuar ofertat me gabime në Volkswagen Connect Shop.
Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të siguruar, që proceset e kontabilitetit të jenë pa gabime dhe të dhënat e financës të përputhen me transaksionet faktike, si dhe për të identifikuar dhe minimizuar rreziqet në lidhje me ofertat dhe blerjet me gabime.

- Pagesa e komisioneve, kompensimet në treg dhe importuesit
  Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të komisionit dhe kompensimit te shitësit dhe importuesit ne krijojmë raporte sipas tregut dhe shitësit me informacione për produktet e blera, kohëzgjatjen e produktit, datën e blerjes, çmimin dhe vlerën e komisionit. Më pas, të dhënat e rëndësishme ofrohen për organizimin e komisioneve të shitjes tek importuesit.
  Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Ne kemi një interes legjitim, për të llogaritur dhe kryer me saktësi pagesat e komisionit, për t'i vënë në dispozicion importuesve dhe shitësve të dhëna të nevojshme dhe për të menaxhuar të dhënat specifike sipas tregut, për të siguruar efikasitetin operacional.

- Monitorimi i produktit, analiza e defektit dhe kryerja e masave korrigjuese të gabimeve
  Ne përpunojmë të dhënat për statusin e kontratës, duke përfshirë kodin VIN, për të identifikuar dhe eliminuar gabimet e produktit dhe për të përcaktuar nëse një klient i prekur ka të drejtë të marrë një kompensim ose për të kryer masa të tjera për eliminimin e gabimeve.
  Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të mbikëqyrur sjelljen e produktit, për të analizuar dhe eliminuar gabimet si dhe për të përcaktuar nëse klientët e prekur kanë të drejtën për kompensim.

- Kompensimi i ofruesit të shërbimit që përdoret për shërbimet online me celular
  Ne krahasojmë nga brenda licencat e blera në Volkswagen Connect Shop me informacionet e licencës të ruajtur në sistemet tona, në mënyrë që t'ua faturojmë shërbimeve që përdorim dhe të përpunojmë pagesat për ofruesin e shërbimit.
  Për qëllimin e lartpërmendur kryhet përpunimi i të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim në përputhje me nenin 6, parag. 1, germa "f" e GDPR. Interesi ynë legjitim ekziston në faktin, për të siguruar një faturim dhe pagesë të saktë për ofruesin tonë të shërbimit, duke kontrolluar dhe llogaritur kompensimin në bazë të licencave të blera dhe shërbimeve të ofruara.

Për këtë përdoren marrësit e mëposhtëm si përpunues të kërkesave:

- Amazon Web Services Inc. (SHBA) – Për ofrimin e një platforme të analizës dhe të të dhënave
- Amazon Web Services EMEA SARL (Luxemburg) – Për ofrimin e një platforme të analizës dhe të të dhënave
- ADASTRA GmbH (Gjermani) – Si zhvillues për Dashboards dhe Reports
- CARIAD SE (Gjermani) – Si zhvillues për Dashboards dhe Reports
- P3 Automotive GmbH (Gjermani) – Për mbështetjen e kolegëve të brendshëm për komunikimin me importuesit
- SCREEN GmbH Training-Beratung (Gjermani) – Për mbështetjen e kolegëve të brendshëm për trajnimin e importuesve në marrëdhënie me Dashboards dhe Reports
- Volkswagen Group Services GmbH (Gjermani) – Për mbështetjen e kolegëve të brendshëm për komunikimin me importuesit

- Volkswagen Group Technology Solutions India Pvt. Ltd. (Indien)
- NTT DATA Deutschland GmbH

Palë të tjera të treta:

- Importuesit (si përgjegjës – Për kompensimin e shitësve dhe importuesve brenda kornizës së ndarjes së fitimit të rënë dakord me kontratë për shitjen e produkteve dixhitale

Marrësit me seli në vendet e treta:

- Përpunimi i të dhënave tuaja personale për qëllimin e raportimeve të brendshme të kompanisë kryhet edhe në një nga retë kompjuterike të Amazon Web Services EMEA SARL ("Amazon") (përpunuesi i kërkesave) që operohet nga Amazon Web Services në Bashkimin Evropian. Një akses në të dhënat personale nëpërmjet Amazon Web Services, Inc. (si përpunues i kërkesave) me seli në SHBA nuk mund të përjashtohet, kështu që janë lidhur klauzola përkatëse standarde kontraktuale të BE (një kontratë e miratuar nga Komisioni Evropian që u jep të dhënave personale të njëjtën mbrojtje që ato kanë në BE për përpunimin e të dhënave në vendet joanëtare të BE). Për qëllimin e përmirësimit dhe zhvillimit të produktit kryhet përpunimi i të dhënave edhe nga Volkswagen Group Technology Solutions India Pvt. Ltd. (si përpunues i kërkesës) në Indi, me të cilin janë lidhur gjithashtu klauzola standarde kontraktuale të BE.

- Klauzolat standarde kontraktuale të përdorura të BE mund t'i thërrisni nëpërmjet URL https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32021D0914.

Volkswagen AG i fshin të dhënat tuaja personale pas 10 vjetësh ose sipas kërkesave ligjore, për shembull sapo përmbushet qëllimi për të cilin janë ato mbledhur, dhe për aq kohë sa nuk ka asnjë detyrim ruajtjeje që të pengojë fshirjen e tyre.

10. Funksionalitete dhe shërbime online / Përpunime të të dhënave në regjimin e flotës (vlen vetëm për vendet e BE– së) të tjera që i përkasin prodhuesit

Automjeti disponon funksionalitete online tashmë që nga fabrika, pa qenë nevoja të lidhet një kontratë e posaçme, si p.sh. "Manuali dixhital i automjetit". Informacionet për përpunimin e të dhënave gjatë përdorimit online të këtyre funksioneve i gjeni te cilësimet e secilit funksion. Udhëzimet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave mund t'i shihni në versionin e fundit të shkarkuar edhe atëherë, nëse automjeti është në modalitetin offline.

Automjeti mund të pajiset (pjesërisht kundrejt pagesës) me SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR "VW Connect" dhe "VW Connect Plus", SHËRBIME të tjera ONLINE ME CELULAR dhe produkte digjitale të Volkswagen AG (si p.sh. aplikacione të caktuara In-Car ose çelësa për celular) ose të jetë lidhur me sistemin e menaxhimit të flotës së automjeteve "Fleet Interface, Connect Pro". Në rastin e sistemeve të menaxhimit të flotës së automjeteve bëhet fjalë për një zgjidhje, e cila i mundëson një operatori të flotës, për të dërguar të dhënat e automjetit dhe për të kontrolluar nga distanca funksionet e automjetit.

Nëse bëhet fjalë për një automjet të flotës së automjeteve, mbledhja e të dhënave nga operatori i flotës së automjeteve mund të ketë të bëjë veçanërisht me të dhënat e mëposhtme, në varësi të teknologjisë dhe pajisjes së automjetit:

- numri i identifikimit të automjetit (VIN)
- të dhënat e mirëmbajtjes (p.sh. ndërrimi i radhës i vajit)
- të dhënat e itinerarit dhe pozicionit
- niveli i mbushjes së serbatorit ose gjendja e karikimit

- dritat paralajmëruese
- etj.

Nëse operuesi i flotës lejon përdorimin paralel me shërbime Volkswagen Connect, te cilësimet e privatësisë në automjet mund të çaktivizohet transmetimi i të dhënave si për te operuesi i flotës ashtu edhe për te aplikacioni Volkswagen.

Operatori i flotës së automjeteve vendos për përcjelljen dhe përpunimin e të dhënave me përgjegjësi individuale (sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave). Për informacionet për përpunimin e të dhënave konkrete kontaktoni operatorin tuaj të flotës së automjeteve.

11. Përdorimi i IA

SHËRBIMET individuale ONLINE ME CELULAR, p.sh. asistenti me zë online IDA, përdorin teknologji mbështetëse për inteligjencën artificiale (IA), për të përpunuar kërkesat në mënyrë më efikase. Përpunimi kryhet gjithmonë bazuar në një bazë juridike ligjore (p.sh. dhënia e pëlqimit ose përmbushja e kontratës) dhe duke respektuar GDPR.

Në rastin e përdorimit të KI: Vendime të automatizuara / profilizim (neni 22 i DSGVO)

Nuk merren vendime bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar, të cilat kanë efekt ligjor mbi ju ose që ju prek ndjeshëm në mënyrë të ngjashme (neni 22 i GDPR). Funksionet e mbështetura te IA (p.sh. IDA) i shërbejnë asistencës dhe nuk kryhen në formën e vendimeve të nenit 22.

12. Këshilla ePrivacy

Për sa kohë që gjatë përdorimit të aplikacionit ose të sistemit të informimit dhe argëtimit aksesohen informacione në pajisjet fundore (p.sh. Cookies, ID lokale), ne, për sa kohë është e domosdoshme marrim miratime të veçanta në përputhje me ligjin kombëtar (p.sh. TDDDG).

II. Marrësit e të dhënave

1. Serveri i të dhënave

Të dhënat personale ruhen në serverët e ofruesve të mëposhtëm të shërbimeve, vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona:

CARIAD SE
Major-Hirst-Straße 7
38442 Wolfsburg
Gjermani

WirelessCar Sweden AB
Vädursgatan 6
412 50 Göteborg
Suedi

Amazon Web Services, Inc. ("AWS")
410 Terry Ave. North
Seattle WA 98109
SHBA

Amazon Web Services EMEA SARL
Avenue John F. Kennedy 38
1855 Luxemburg
Luksemburg

Microsoft Ireland Operations Limited
One Microsoft Place
South County Business Park
Leopardstown
Dublin 18
D18 P521
Irlandë

Elli Mobility GmbH
Karl-Liebknecht-Str. 32
10178 Berlin
Gjermani

Ford Motor Company
One American Road
Dearborn, MI 48126
SHBA
(Vlen vetëm për Volkswagen Amarok (nga viti i modelit 2023) dhe Transporter/Caravelle (nga viti i modelit 2025))

2. Ofruesi i shërbimeve IT

Përveç kësaj, ne përdorim edhe ofrues të ndryshëm të shërbimeve IT, si brenda ashtu edhe jashtë BE-së. Ata na mbështetin, për shembull, me mirëmbajtjen e sistemeve tona IT dhe me asistencë teknike. Për aq kohë sa ofruesit marrin akses për shërbimet e të dhënat personale, ata i përpunojnë ato vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.

Asistenca për IT ofrohet veçanërisht nga ofruesit e mëposhtëm të shërbimeve:

CARIAD SE
Major-Hirst-Straße 7
38442 Wolfsburg
Gjermani

dx.one GmbH Berliner Ring 2 38440 Wolfsburg Gjermani

3. Marrës të tjerë

Marrësit e tjerë të të dhënave personale mund të merren në informacionet e secilit nga shërbimet dhe funksionalitetet individuale në këtë Politikë privatësie.

4. Marrësit me seli në vendet e treta

Volkswagen AG i transferon të dhënat personale për arsye të përmendura në këtë politikë për privatësinë edhe te marrësi dhe përpunuesi i kërkesave që e kanë selinë e tyre jashtë BE. Për garantimin e një niveli të përshtatshëm të mbrojtjes për të dhënat personale, Volkswagen AG vendos klauzolat standarde kontraktuale të BE me marrësit në vendet e treta të pasigurta. Klauzolat standarde kontraktuale të përdorura të BE mund të hapen në gjuhët e BE-së, në adresën

e URL https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32021D0914. Përveç kësaj – kur kërkohet nga ligjet e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave – merren masa të tjera mbrojtëse (p.sh. enkriptimi dhe rregulloret kontraktuale shtesë) për të garantuar një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për të dhënat personale.

5. Kërkesat ligjore për zbulimin e të dhënave

Për aq kohë sa ekzistojnë kërkesat ligjore, me kërkesë të organeve shtetërore (p.sh. kur hetohet një vepër penale) ne jemi të detyruar t'i dorëzojmë të dhënat e ruajtura nga ne, deri në masën e nevojshme. Baza ligjore për transferimin e të dhënave në organin shtetëror përkatës është detyrimi ligjor përkatës (neni 6, paragrafi 1, germa "c" e GDPR në lidhje me detyrimin ligjor përkatës).

III. Fshirja dhe korrigjimi i të dhënave personale

Sapo të dhënat personale të mos jenë më të nevojshme për qëllimin apo për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur, ato do të fshihen nga ne, për aq kohë sa ky veprim nuk bie ndesh me detyrimet ligjore të ruajtjes së të dhënave.

Nëse automjeti fshihet nga garazhi virtual i automjeteve në aplikacion, do të fshihet edhe përdoruesi nga lista e përdoruesve të automjetit. Lutemi të mbahet parasysh se fshirja e të dhënave nga automjeti bëhet vetëm nëse rikthehet automjeti në cilësimet e fabrikës, nëpërmjet sistemit të informimit dhe argëtimit.

Veç kësaj, klientët tanë mund t'i korrigjojnë në çdo moment të dhënat që kanë vendosur te cilësimet e Volkswagen ID, nëse kanë krijuar një të tillë.

E. Përpunimi i të dhënave në detaje

I. Volkswagen ID

Volkswagen ID u ofron klientëve tanë mundësinë që të regjistrohen te shërbime, aplikacione dhe ueb sajte të shumta të Volkswagen AG ose palëve të treta. Përpunimi i të dhënave të nevojshme bëhet në kuadër të zbatimit të kontratës (neni 6, paragrafi 1, faqe 1, germa "b" e GDPR). Volkswagen ID shërben si llogari qendrore përdoruesi, në mënyrë që klientët tanë të mund t'i menaxhojnë të dhënat e tyre personale në qendër. Për të përdorur një SHËRBIM ONLINE ME CELULAR, është e nevojshme të krijoni një Volkswagen ID ose të hyni në një llogari përdoruesi ekzistuese të Volkswagen ID. Shërbimi i zgjedhur nga klienti lidhet me Volkswagen ID të klientit. Kjo lidhje bëhet vetëm pas miratimit të klientit (neni 6, paragrafi 1, fq. 1, germa "a" e GDPR). Informacionet për përpunimin e të dhënave në lidhje me Volkswagen ID gjenden në politikën për privatësinë, e cila mund të thirret online në adresën https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/IdentityKit/de/sq/volkswagen-dataPrivacy/latest/html.

II. Volkswagen Ident

Përpara përdorimit të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR, të cilat mundësojnë aksesin për automjetin (p.sh. nëpërmjet "Mbyllja dhe hapja"), duhet kryer një verifikim i identitetit (Volkswagen Ident).

Verifikimet e mbledhura mund të shkëmbehen midis kompanive brenda Volkswagen AG (Group), për të shmangur një verifikim të shumëfishtë nga ana e përdoruesit.

1. Procesi Volkswagen Ident me AutoIdent nëpërmjet portalit MyVolkswagen dhe aplikacionit Volkswagen

AutoIdent nga IDnow është një zgjidhje e identifikimit, e cila u mundëson klientëve të identifikohen online dhe në kohë reale. Klienti ngarkon një dokument identifikimi të lexueshëm nga pajisjet kompjuterike, si p.sh. një kartë identiteti, një pasaportë ose një patentë (në varësi të përcaktimeve të vlefshme në vendin e klientit) dhe bën një video të shkurtër selfie. Më pas, softueri i AutoIdent verifikon automatikisht vërtetësinë e dokumentit dhe e krahason atë me videon, për t'u siguruar që bëhet fjalë vërtet për personin që dëshiron të identifikohet. Sapo identiteti të jetë verifikuar me sukses, klienti mund të konfirmojë online identitetin e tij dhe të përdorë SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR, të cilat mundësojnë p.sh. aksesin për automjetin (p.sh. nëpërmjet "Mbyllja dhe hapja").

Sipas ofruesit të autorizuar të shërbimit, për më tepër transmetohet "Volkswagen ID" (numri i brendshëm i identifikimit për caktimin unik të të dhënave të klientit).

Ky numër identifikimi pasurohet me të dhëna të tjera (p.sh. foto portret) nga ofruesi i autorizuar i shërbimit, gjatë procesit të identifikimit. Në këtë mënyrën klienti mund të informohet paraprakisht për këtë veçmas dhe duhet të japë shprehimisht miratimin, në mënyrë që të mund të përpunojmë të dhënat. Përpunimi i të dhënave bëhet në këtë rast në bazë të nenit 6, paragrafi 1, germa "a" e GDPR dhe nenit 9, paragrafi 2, germa "a" e GDPR në bazë të dhënies së pëlqimit të klientit vetëm për qëllimin e identifikimit, për të aktivizuar SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR, për të cilat është e nevojshme një identifikim unik. Një transmetimi i të dhënave bëhet vetëm në mënyrë të enkriptuar.

Pas përfundimit të identifikimit, mbiemri, emri, datëlindja dhe Volkswagen ID e klientit si dhe momenti i identifikimit, transmetohen nga ofruesi i shërbimit te ne, me qëllim dokumentimin e rezultatit dhe aktivizimin e SHËRBIMIT ONLINE ME CELULAR. Përveç kësaj, transmetohen edhe lloji i dokumentit, numri i dokumentit, vendi i lëshimit, data e lëshimit dhe afati i vlefshmërisë me qëllim që të dokumentohet, se me cilin dokument identifikimi është identifikuar klienti.

Ne vlerësojmë, nëse procesi Volkswagen Ident ka përfunduar me sukses apo është ndërprerë. Për këtë arsye ne e ruajmë statusin e procesit të verifikimit të një klienti. Faqja e përparme dhe faqja e pasme e dokumentit, shenja e regjistruar e sigurisë së dokumentit të identifikimit, si dhe fotot e fytyrës ruhen në IDnow për qëllime verifikimi dhe fshihen pas maksimumi dhjetë (10) ditësh.

Të dhënat personale ruhen në Volkswagen për aq kohë, derisa klienti ta fshijë llogarinë e tij të përdoruesit Volkswagen ID.

Informacionet e ofruesit palë e tretë:

IDnow GmbH
Auenstraße 100
80469 München
Gjermani

Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe në përputhje me udhëzimet tona.

2. Procesi Volkswagen Ident tek partneri juaj i servisit të Volkswagen

Si alternativë, për identifikimin online (AutoIdent) klientët mund të verifikojnë në vend identitetin e tyre te një partner i servisit Volkswagen, nëse ofrohet ky shërbim. Verifikimi i identitetit shërben për aktivizimin e SHËRBIMEVE të caktuara ONLINE ME CELULAR të rëndësishme për sigurinë, të cilat mundësojnë aksesin për automjetin (p.sh. "Mbyllja dhe hapja", "Çelësi për celular").

Kushti paraprak është, që klientët të disponojnë një Volkswagen ID dhe të jenë regjistruar në portalin e klientit. Te partneri i servisit Volkswagen në vend verifikohet identiteti në kuadër të ftesës për përdorimin e shërbimeve dixhitale të Volkswagen AG Pre Delivery Enrollment (Pre Delivery Enrollment) me anë të një dokumenti zyrtar identifikimi (leje drejtimi, kartë identiteti ose pasaportë) të klientit. Informacionet për përpunimin e detajuar të të dhënave në lidhje me procesin e PDE ju i merrni te "Politika për privatësinë për ftesën për përdorimin e shërbimeve dixhitale të Volkswagen AG (Politika për privatësinë PDE)", mund të thirren online te https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/pre-delivery-enrolment/al/sq-al/data-protection/latest/html.

Ndërkohë, partneri i servisit Volkswagen bëhet aktiv si përpunues i kërkesës së VOLKSWAGEN AG dhe i përpunon të dhënat personale vetëm sipas porosisë sonë dhe me qëllimin, për të verifikuar identitetin e klientit dhe për të mundësuar përdorimin e SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR të rëndësishme për sigurinë. Të dhënat transmetohen të koduara te VOLKSWAGEN AG. Te partneri i servisit Volkswagen të dhënat nuk ruhen vazhdimisht.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të këtij verifikimi identiteti është neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (kontrata ose përgatitja e kontratës nëpërmjet përdorimit të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR).

F. Portofoli i shërbimeve "VW Connect" në automjetet e "familjes ID."

Shërbimet e renditura më poshtë nga portofoli "VW Connect" janë të disponueshme në varësi të vitit të prodhimit dhe pajisjes së automjetit, versionit të softuerit të instaluar në automjet të SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR dhe në varësi të shtetit në automjet. Përdoruesi kryesor dhe, sipas rastit, përdoruesi i automjetit mund t'i çaktivizojnë shërbimet e caktuara të portofolit të shërbimeve në aplikacionin "Volkswagen", ("**Aplikacioni**") dhe t'i aktivizojnë përsëri nëse nevojitet (krahaso seksionin C.I.2.c) "Kufizimi i përpunimit të të dhënave (Cilësimet e privatësisë)".

Më poshtë jepet një përmbledhje e të dhënave që përpunohen në kuadër të shërbimit përkatës, e bazës ligjore të përpunimit, si dhe e marrësve përkatës të të dhënave. Marrësit e të dhënave, të cilët i marrin të dhënat personale nëpërmjet shërbimeve gjenden në seksionin C.II. "Marrësit e të dhënave".

Shërbimet që përpunojnë të dhënat e vendndodhjes identifikohen me anë të simbolit *.

1. Oraret e nisjes

Me funksionin "Kohët e nisjes", përdoruesi kryesor dhe përdoruesi kanë mundësinë që me anë të aplikacionit të kryejnë vendosjen e profilit të karikimit (gjendja minimale e karikimit, gjendja maksimale e karikimit, kufizimi i rrymës së karikimit, aktivizimi automatik i spinës së karikimit, kohët e preferuara të karikimit, emri i profilit të karikimit), si dhe të përcaktojnë kohën në të cilën bateria e automjetit ID. duhet të jetë e karikuar në një vend karikimi. Përveç kësaj, mund të caktohet nëse automjeti duhet të jetë i klimatizuar në kohën e nisjes që dëshironi (klimatizimi në gjendje të ndaluar).

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), koha e dëshiruar për shërbimet "Karikimi" dhe "Klimatizimi", gjendja (aktuale) e cilësimit të profilit të karikimit

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet, sipas kontratës për përdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

2. Klimatizimi

Me "klimatizimin", përdoruesi kryesor dhe përdoruesi kanë mundësinë të rregullojnë me anë të aplikacionit para nisjes së udhëtimit temperaturën e brendshëm të automjetit nëpërmjet kondicionerit (klimatizimi në gjendje të ndaluar) dhe të (ç)aktivizojnë ngrohjen e xhamave pa qenë nevoja që të ndodhen vetë në automjet.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), cilësimet e klimatizimit, statusi i ngrohjes së xhamave, gjendja (aktuale) e klimatizimit në gjendje të ndaluar

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet, sipas kontratës për përdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

3. Karikimi

Me funksionin "Karikimi", përdoruesi kryesor dhe përdoruesi kanë mundësinë që me anë të aplikacionit të komandojnë karikimin e baterisë së automjetit (Start/Stop), të konfigurojnë procesin e karikimit dhe të kërkojnë statusin e karikimit (gjendja e karikimit të baterisë, autonomia e mbetur, statusi i spinës së karikimit, koha e mbetur e karikimit).

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), cilësimet e karikimit, gjendja (aktuale) e statusit të karikimit

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet, sipas kontratës për përdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

4. "We Charge" – Stacionet e lira të karikimit

Pasazhet e mëposhtme vlejnë për aplikacionin In-Car "We Charge" me versionin e softuerit 2.7.0.

Funksioni "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë" nga "We Charge" mundëson shfaqjen e kolonave të karikimit gjatë përdorimit të navigimit të automjetit tuaj. Do t'ju shfaqet se cilat stacione karikimi janë të disponueshme dhe cilat jo. Për më tepër, në pamjen e detajeve të një kolone karikimi ju shikoni shpejtësinë e karikimit.

Funksioni "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë" mund të përdoret vetëm nëse ne kemi akses në vendndodhjen e automjetit (pozicioni gjeografik) ose në një adresë të dhënë nga ju dhe mund t'i përpunojmë këto të dhëna. Përpunimi i të dhënave të pozicionit gjeografik bëhet vetëm kur keni dhënë miratimin për këtë para përdorimit të shërbimit. Sigurisht që ju mund ta revokoni në çdo kohë dhënien e pëlqimit tuaj pa dhënë ndonjë arsye kundrejt Volkswagen AG me efekt për të ardhmen, p.sh. nëpërmjet emailit në adresën info-datenschutz@volkswagen.de dhe

nëpërmjet të dhënave të kontaktit të dhënë në të dhënat e botimit si dhe në varësi të pjesës së përparme te cilësimet ose duke thirrur sërish planifikuesin elektronik të itinerarit. Megjithatë, në këtë rast funksioni nuk është më i disponueshëm për ju.

Të dhënat personale: Pozicioni gjeografik ose adresa (mund të zgjidhet lirshëm), kategoria e memories: nuk kryhet asnjë ruajtje e përhershme e të dhënave

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "a" e GDPR (dhënia e pëlqimit) për përdorimin e pozicionit gjeografik, neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (zbatimi i kontratës) për përdorimin e adresës së zgjedhur

Marrës të tjerë të të dhënave: Volkswagen Group Charging GmbH, Karl-Liebknecht-Str. 32, 10178 Berlin, Gjermani; Volkswagen Software Asset Management GmbH, Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani; Microsoft Ireland Operations Limited, One Microsoft Place, South County Business Park, Leopardstown, Dublin 18 D18 P521, Irlandë; WirelessCar Sweden AB, Vädursgatan 6, 412 50 Göteborg, Suedi

Për më tej, ne përdorim ofruesin e shërbimit, i cili i përpunon të dhënat personale me përgjegjësi individuale. Këtu ne përdorim Google Ireland Limited (Gordon House, Barrow Street, DUBLIN 4, Irlandë). Informacione të ngjashme për përpunimin e të dhënave në Google gjeni nëpërmjet URL https://policies.google.com/privacy.

Pasazhet e mëposhtme vlejnë për aplikacionin In-Car "We Charge" duke filluar nga versioni i softuerit 5.4.0.

I. Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë

Funksioni "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë" nga "We Charge" mundëson shfaqjen e kolonave të karikimit gjatë përdorimit të navigimit të automjetit tuaj. Do t'ju shfaqet se cilat stacione karikimi janë të disponueshme dhe cilat jo. Për më tepër, në pamjen e detajeve të një kolone karikimi ju shikoni shpejtësinë e karikimit.

Nëpërmjet aktivizimit të funksionit "Zonat e preferuara të karikimit" (disponueshmëria në varësi të pjesës së përparme), juve ju shfaqen rekomandimet për kolonat e karikimit brenda një rrezeje të përcaktuar për adresën tuaj të shtëpisë (shtëpia) në navigimin e automjetit. Këto rekomandime të karikimit ne mund t'jua shfaqim vetëm, nëse ndodheni brenda rrezes së përcaktuar. Këtë e gjejmë me anë të pozicionit gjeografik të automjetit tuaj. Kolonat e rekomanduara të karikimit zgjidhen me anë të parametrave si për shembull çmimi, distanca dhe shpejtësia e karikimit. Rekomandimet më të volitshme të kolonave të karikimit juve ju shfaqen vetëm me një tarifë të prenotuar.

Funksioni "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë" mund të përdoret vetëm nëse ne kemi akses në vendndodhjen e automjetit (pozicioni gjeografik) ose në një adresë të dhënë nga ju dhe mund t'i përpunojmë këto të dhëna.

Funksioni "Zonat e preferuara të karikimit" mund të përdoret vetëm nëse ne kemi akses në vendndodhjen e automjetit (pozicioni gjeografik) dhe mund të përpunojë këto të dhëna.

Përpunimi i të dhënave të pozicionit gjeografik bëhet vetëm kur keni dhënë miratimin për këtë para përdorimit të shërbimit. Sigurisht që ju mund ta revokoni në çdo kohë dhënien e pëlqimit tuaj pa dhënë ndonjë arsye kundrejt Volkswagen AG me efekt për të ardhmen, p.sh. nëpërmjet emailit në adresën info-datenschutz@volkswagen.de dhe nëpërmjet të dhënave të kontaktit të dhënë në të dhënat e botimit si dhe në varësi të pjesës së përparme te cilësimet ose duke thirrur sërish planifikuesin elektronik të itinerarit. Megjithatë, në këtë rast funksioni nuk është më i disponueshëm për ju.

Të dhënat personale: Pozicioni gjeografik ose adresa (e shtëpisë) (mund të zgjidhet lirshëm)

Kategoria e ruajtjes: Nuk kryhet asnjë ruajtje e vazhdueshme e të dhënave

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "a" e GDPR (dhënia e pëlqimit) për përdorimin e pozicionit gjeografik, neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (zbatimi i kontratës) për përdorimin e adresës së zgjedhur

II. Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë, treguesi i detajeve dhe kostove

Nëse përdorni funksionin "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë, treguesi i detajeve dhe kostove", ne përpunojmë të dhënat tuaja personale, duke i verifikuar me anë të një Token, se cilat tarifa vlejnë për ju në një kolonë karikimi, për të mund t'jua shfaqur ato juve. Token mbron aksesin për tarifat tuaja personale të karikimit tek Elli Mobility GmbH (në vijim "Elli"). Ky gjendet nga ID e përdoruesit dhe nga një autorizim i aksesit për tarifat tuaja të karikimit.

Nëpërmjet aktivizimit të funksionit "Zonat e preferuara të karikimit", me ndihmë të tarifës suaj të prenotuar shfaqen rekomandimet e kolonave të karikimit. Kolonat e rekomanduara të karikimit zgjidhen me anë të parametrave si për shembull çmimi, distanca dhe shpejtësia e karikimit.

Treguesi i detajeve dhe kostove është i mundur vetëm nëse përdorni shërbimin e karikimit "We Charge" (karikimi publik). Kjo vlen edhe për funksionalitetin "Zonat e preferuara të karikimit". Kini parasysh që shërbimi i karikimit "We Charge" (karikimi publik) pavarësisht nga përpunimet e përshkruara të të dhënave në këtë politikë privatësie, veçanërisht për ofrimin e hartës së karikimit, për tarifat e karikimit, mënyrat e pagesës, përdorimin e shërbimit të karikimit dhe ruajtjen e proceseve të karikimit në kuadër të proceseve të karikimit të Elli, në Gjermani dhe Volkswagen Group Charging CZ s.r.o., në Republikën Çeke, (brenda Republikës Çeke) ofrohen me përgjegjësi të përbashkët. Informacione të mëtejshme për përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Elli dhe për zbatimin e të drejtave tuaja kundrejt Elli gjeni në udhëzimet për mbrojtjen e të dhënave të Elli te https://www.elli.eco/de/datenschutzerklaerung?brand=elli-website.

Të dhënat personale: Disponohet tarifa e Elli (po/jo), ID e përdoruesit, Elli Token

Kategoria e ruajtjes: Ne i përpunojmë këto të dhëna për krahasimin, për t'ju mundësuar juve treguesin e detajeve dhe kostove të kolonave të karikimit, një ruajtje e përhershme nuk kryhet më tej

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e një kontrate)

III. Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë, Remote Charging

Nëse përdorni funksionin "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë", Remote Charging, atëherë mund të filloni dhe ndaloni karikimin. Në varësi të disponueshmërisë së funksionit në pjesën e përparme përkatëse në bazë të përdorimit të karikimit të bazuar në llogaritje juve ju shfaqen në kohë reale kostot e karikimit duke pasur parasysh tarifën e karikimit të vlefshme për ju. Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale duke i verifikuar me anë të një Token, se cilat tarifa vlejnë për ju në një kolonë karikimi. Token mbron aksesin për tarifat tuaja personale të karikimit tek Elli. Ky gjendet nga ID e përdoruesit dhe nga një autorizim i aksesit për tarifat tuaja të karikimit. Kini parasysh që kostot faktike të karikimit mund të ndryshojnë nga kjo në rast individual.

Funksioni Remote Charging është i mundur vetëm nëse përdorni shërbimin e karikimit "We Charge" (karikimi publik), d.m.th. nëse keni lidhur një tarifë të vlefshme me Elli. Informacionet për përpunimin e të dhënave tek Elli gjeni në paragrafin "Kërkimi dhe gjetja e kolonave të karikimit në hartë, treguesi i detajeve dhe kostove".

Të dhënat personale: ID e përdoruesit, pika e karikimit (e ashtuquajtur EVSE), Elli Token, ID e kolonave të karikimit me ID e sesionit, ID e stacionit dhe ID e EVSE, data e nisjes, data e mbarimit dhe kohëzgjatja e karikimit

Kategoria e ruajtjes: Ne i përpunojmë këto të dhëna për krahasimin, për t'ju mundësuar juve treguesin e detajeve të kolonave të karikimit bashkë me një tregues të çmimit të bazuar në llogaritje si dhe (remote) funksionin e nisjes dhe ndalimit, një ruajtje e përhershme nuk kryhet më tej.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e një kontrate)

IV. Feedback i klientit për kolonat e karikimit

Funksioni "Feedback i klientit për kolonat e karikimit" ju mundëson, për të vlerësuar me yje përdorimin e kolonave të karikimit. Për më tepër, mund të njoftoni për problemet në rastin e përdorimit të kolonave të karikimit. Me këtë vlerësim përdoruesit e tjerë mund të vlerësojnë më mirë cilësinë dhe fuqinë e kolonave të karikimit. Vlerësimi juaj shfaqet për një vit dhe më pas fshihet.

Përdorimi i funksionit të Feedback është i mundur vetëm nëse keni dhënë pëlqimin tuaj për përpunimin e Feedback tuaj (Feedback-Consent).

Sigurisht që ju mund ta revokoni në çdo kohë dhënien e pëlqimit tuaj pa dhënë ndonjë arsye kundrejt Volkswagen AG me efekt për të ardhmen, p.sh. nëpërmjet emailit në adresën info-datenschutz@volkswagen.de, nëpërmjet të dhënave të kontaktit të dhënë në të dhënat e botimit si dhe në llogarinë e përdoruesit Volkswagen ID. Nëpërmjet revokimit të pëlqimit nuk preket ligjshmëria e përpunimit të kryer deri në revokim. Në këtë rast, funksioni Feedback nuk është më i disponueshëm.

Të dhënat personale: Feedback-Consent, Feedback (feedback i klientit për kolonat e karikimit)

Kategoria e ruajtjes: për Feedback-Consent: 5 vjet; për Feedback (feedback i klientit për kolonat e karikimit): 1 vit duke filluar nga krijimi

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "a" e GDPR (Dhënia e pëlqimit)

5. Navigimi – stacionet e karikimit*

"Stacionet e karikimit" kërkojnë stacionet e përshtatshme të karikimit në afërsi të vendndodhjes aktuale të automjetit. Aplikacioni tregon numrin total dhe vendet e lira të stacionit të karikimit dhe informon për distancat.

Të dhënat personale: Adresa IP e automjetit; TileID e rajonit në afërsi të automjetit

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 24 orësh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës), neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës së "VW Connect" kundrejt përdoruesit kryesor)

Marrës të tjerë të të dhënave: Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

6. Navigimi – përditësimi online i hartave*

Me "përditësimin e hartave", materiali i hartës mund të përditësohet online drejtpërdrejt në automjet. Për këtë, automjeti analizon se cilat rajone brenda një vendi janë të rëndësishme për automjetin dhe cilat rajone përshkohen më shumë nga automjeti.

Të dhënat personale: Adresa IP e automjetit, TileID e rajoneve që janë përshkuar më shumë (vetëm me përditësimin automatik); numri i versionit të të dhënave të ruajtura aktualisht në hartë

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 24 orësh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës), neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës së "VW Connect" kundrejt përdoruesit kryesor)

Marrës të tjerë të të dhënave: HERE Europe B.V., Kennedyplein 222 –226, 5611 ZT Eindhoven, Niederlande. (Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

7. Navigimi online - Vendet e parkimit*

Me "Vendet e parkimit" kërkohen vende parkimi të përshtatshme në rrezen e pozicionit aktual të automjetit, nëse këto janë të disponueshme. Aplikacioni informon për çmimet, oraret e hapjes, distancat dhe numrat e telefonit.

Të dhënat personale: Adresa IP e automjetit; Rajoni TileID në afërsi të automjetit

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 24 orësh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës), neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës së "VW Connect" kundrejt përdoruesit kryesor)

Marrës të tjerë të të dhënave: Parkopedia Ltd. 232 Sladepool Farm Road, Birmingham, B14 5EE, Vereinigtes Königreich; Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani. (Këta marrës i përpunojnë të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

8. Navigimi online - Llogaritja online e itinerarit*

"Llogaritja e itinerarit" llogarit itinerarin më të mirë për automjetin duke marrë parasysh gjendjen aktuale të trafikut.

Të dhënat personale: Adresa IP e automjetit, vendndodhja e automjetit, nisja/destinacioni, drejtimi i udhëtimit, cilësimet e itinerarit

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 24 orësh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës), neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës së "VW Connect Plus" kundrejt përdoruesit kryesor)

Marrës të tjerë të të dhënave: Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani. (Ky marrës i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

9. Importimi online i destinacionit / Importimi online i itinerarit

Me funksionin "Importimi online i destinacionit / Importimi online i itinerarit", përdoruesi kryesor ose përdoruesi mund të dërgojë tashmë përpara nisjes së udhëtimit pika interesi të veçanta (PMI) të krijuara në aplikacion si dhe të itinerareve të krijuara në sistemin e navigimit të automjetit. Destinacioni i dërguar ose itinerari i dërguar do të jetë i dukshëm për përdoruesin aktual të automjetit në sistemin e navigimit, sapo automjeti të përdoret online.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit i automjetit (VIN), koncepti i kërkimit, koordinatat e seksionit të hartës, adresa IP, vendet (me interes) të dërguara, itineraret e krijuara nga përdoruesi, statusi i disponueshmërisë së funksionit në automjet (për të dërguar destinacionet)

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); Neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës së "VW Connect" kundrejt përdoruesit kryesor)

Marrës të tjerë të të dhënave: Google Ireland Limited Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irland

10. Informacionet online mbi trafikun*

Funksioni "Informacionet online mbi trafikun" informon rreth situatave aktuale të trafikut dhe shfaq fluksin e trafikut në hartë dhe përgjatë itinerarit të sistemit të navigimit.

Të dhënat personale: Adresa IP; TileID e rajonit të kërkuar në afërsi ose përgjatë itinerarit.

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 24 orësh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës), neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës së "VW Connect" kundrejt përdoruesit kryesor)

Marrës të tjerë të të dhënave: Joynext GmbH, Gewerbepark Merbitz Nr. 5, 01156 Dresden, Gjermani, sowie NIRA Dynamics AB, Wallenbergs gata 4, 58330 Linköping, Schweden. (Ky marrës i të dhënave i përpunon të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

11. Komandimi online me zë / Asistenti online me zë IDA* (në dispozicion në varësi të modelit dhe pajisjes)

"Komandimi online me zë" / "Asistenti online i gjuhës IDA" i ofron përdoruesit kryesor dhe përdoruesve një komandim intuitiv me zë dhe është në dispozicion edhe për komandimin offline me zë / për asistentët offline me zë në automjet (i disponueshëm vetëm në gjuhët e mëposhtme: anglisht (GB), anglisht (US), gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, çekisht, holandisht, polonisht, portugalisht, suedisht, danisht, norvegjisht).

Komandimi me zë / asistenti i gjuhës IDA mund të aktivizohet përmes butonit Push-to-Talk në timon ose përmes një fjale aktivizuese, për të formuluar më pas një kërkesë. Me anë të fjalës aktivizuese, "komandimi me zë" / "asistenti me zë IDA" mund të përdoret edhe nga pasagjerët e automjetit. Për përdorimin e fjalës aktivizuese është një shërbim që punon në sfond në sistemin e informimit dhe të argëtimit të automjetit, i cili identifikon se kur shqiptohet fjala aktivizuese. Në raste të rralla mund të ndodhë që ky shërbim në sfond, ta identifikojë pa dashje fjalën aktivizuese.

Në momentin që aktivizohet "komandimi me zë" / "asistenti me zë IDA" përmes butonit Push-to-Talk ose fjalës aktivizuese, ai shfaqet në ekranin e sistemit të informimit dhe argëtimit, përmes një simboli grafik. Komandimi "online me zë" / "Asistenti online me zë IDA" mund të ndalet gjithashtu me komandimin me zë "Pauzë". Në gjendjen e ndalur, nuk transferohen të dhëna ose fjalë të folura në automjet. Gjendja e ndalur mund të anulohet duke thënë përsëri fjalën e aktivizimit ose duke shtypur butonin "Push-to-Talk" në timon.

Avantazhi i komandimit online me zë / asistentit me zë online IDA kundrejt komandimit offline me zë / asistentit me zë pa lidhjen online është një identifikim zanor më i mirë në përgjithësi dhe mundësi për të komanduar përmbajtjet online me anë të komandave zanore, për shembull shërbimet Streaming (Radio interneti), pikat e interesit për navigimin si dhe mundësi për thirrjen e informacioneve për temat si moti, lajmet, dija, sporti, statusi i udhëtimit dhe aksionet. Nëse klienti jep gjithashtu një pëlqim për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes për komandimin online me zë / asistentin me zë online IDA, atëherë ai merr rezultate edhe më të mira, më të shpejta të navigimit, të cilat pasurohen me informacione shtesë (p.sh. informacionet për kolonat e karikimit) dhe mund të thirren informacionet për mjedisin e tij përreth (të disponueshme në varësi të modelit dhe pajisjes si dhe në varësi të gjuhës së konfiguruar të sistemit). Edhe pa dhënien e pëlqimit ose në rastin e anulimit të dhënies së pëlqimit, komandimi online me zë / asistenti online i gjuhës IDA vazhdon të jetë i përdorshëm në masën e garantuar me kontratë.

Asistenti online me zë IDA plotësohet nëpërmjet lidhjes me ChatGPT, duke i përcjellë më tej kërkesat, të cilave asistenti online me zë IDA nuk mund t'u përgjigjet te ChatGPT. Për më tepër, ofruesi i shërbimit Cerence GmbH verifikon, nëse mund t'i përgjigjet kërkesës së gjuhës. Nëse kjo nuk ndodh, kërkesa e gjuhës përcillet më tej në formë teksti te ChatGPT. ChatGPT dërgon një përgjigje në formë teksti tek ofruesi i shërbimit Cerence GmbH dhe nga ai kthehet tek automjeti. Në rastin e dhënies së përgjigjes në automjet bëhet e qartë, nëse bëhet fjalë për një ngjarje të gjeneruar nga ChatGPT. Një përcjellje e mëtejshme e të dhënave të vendndodhjes te ChatGPT nuk ndodh, në rastin e përpunimit të kërkesës së gjuhës nëpërmjet ChatGPT.

Nëse automjeti përdoret në modalitet offline, të dhënat zanore do të përpunohen vetëm në automjet. Të dhënat e vendndodhjes nuk përpunohen (komandimi offline me zë / asistenti offline i gjuhës). Funksionaliteti online mund të çaktivizohet në fushën personale të hyrjes në shfletuesin e internetit ose përmes aplikacionit. Përveç kësaj, mund të çaktivizohet identifikimi i fjalës aktivizuese në sistemin e informimit dhe të argëtimit, në mënyrë që komandimi me zë / asistenti me zë IDA të mund të përdoret vetëm përmes butonit Push-to-Talk.

Për vizitorin "komandimi online me zë" / "asistenti online i gjuhës IDA" nuk është i disponueshëm. Të dhënat do të përpunohen vetëm në automjet.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendi depozitues nga ana e sistemit ose pozicioni aktual i automjetit (nëse jepet gjithashtu pëlqimi për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes për komandimin online me zë / asistentin me zë online IDA), gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit, marka e automjetit, kodi ID i përdoruesit të përdoruesit kryesor të automjetit, kodi rajonal dhe numri i versionit të softuerit të sistemit të informimit dhe argëtimit, gjuha e folur dhe gjuha e përgjigjes (vetëm për gjuhët EN-US, EN-GB, DE, FR, ES, IT, CZ, NL, PL, PT, SE, DK, NO)

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 30 ditësh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës); për përpunimin opsional të pozicionit aktual të automjetit: neni 6, parag. 1, germa "a" e GDPR (dhënia e pëlqimit); për pasagjerët e tjerë të automjetit pa kontratë nëpërmjet SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesi legjitim: zbatimi i kontratës "We Connect" kundrejt përdoruesit kryesor).

Marrës të tjerë të të dhënave: e.solutions GmbH, Despag-Straße 4a, 85055 Ingolstadt, Gjermani; Cerence GmbH, Jülicher Straße 376, 52070 Aachen, Gjermani (Këta marrës i përpunojnë të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

12. Komandimi online me zë për AMAROK (duke filluar nga viti i modelit 2023) dhe Transporter/Caravelle (duke filluar nga viti i modelit 2025)

Me SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR të "VW Connect Basic", krahas komandimit offline me zë në automjet, përdoruesit kryesorë të automjetit kanë në dispozicion në AMAROK edhe komandimin online me zë.

Komandimi online me zë në Amarok dhe Transporter/Caravelle të ri është ndërkohë në dispozicion për gjuhët e mëposhtme: Gjermanisht, anglisht (GB), frëngjisht, spanjisht, çekisht, italisht, holandisht, suedisht, rusisht, danisht, portugalisht, turqisht, finlandisht, norvegjisht, dhe polonisht.

Për të siguruar funksionalitetin e komandimit online me zë në masën e garantuar në kontratë, vendndodhja e automjetit dërgohet sapo të keni aktivizuar SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR në aplikacionin tuaj Volkswagen. Data përkatëse e vendndodhjes do të fshihet menjëherë pas përdorimit (maksimumi pas 30 ditësh).

"Komandimin me zë" mund ta aktivizoni përmes butonit Push-to-Talk në timon ose përmes një komande aktivizuese, për të formuluar më pas kërkesën tuaj. Përmes fjalës aktivizuese, "Komandimi online me zë" mund të përdoret edhe nga pasagjerët e automjetit. Për përdorimin e fjalës aktivizuese është një shërbim që punon në sfond në sistemin e informimit dhe të argëtimit të automjetit, i cili identifikon se kur shqiptohet fjala aktivizuese. Në raste të rralla mund të ndodhë që ky shërbim në sfond, ta identifikojë pa dashje fjalën aktivizuese.

Në momentin që aktivizohet "komandimi me zë" përmes butonit Push-to-Talk ose fjalës aktivizuese, ai do të shfaqet në ekranin e sistemit të informimit dhe argëtimit, përmes një simboli grafik. Përparësia e "Komandimit online me zë" në raport me komandimin offline me zë është një identifikim më i mirë zanor në përgjithësi dhe mundësia për të komanduar përmbajtjet online përmes komandave zanore, si për shembull pikat e interesit për navigimin.

Cerence GmbH vlerëson komandat zanore përmes procesesh të automatizuara, për qëllime raportimi për ne dhe na vë në dispozicion rezultatet e vlerësimit (pa skedarët zanorë dhe audio), kur përdorni komandimin online me zë. Ju mund ta çaktivizoni në çdo kohë lidhjen online për "komandimin online me zë" në sistemin e informimit dhe argëtimit. Në këtë rast të dhënat zanore do të përpunohen vetëm në automjet. Përveç kësaj, mund të çaktivizoni identifikimin e fjalës aktivizuese në sistemin e informimit dhe të argëtimit, në mënyrë që komandimi me zë të mund të përdoret vetëm përmes butonit Push-to-Talk. Nëse e përdorni automjetin në modalitet offline, të dhënat zanore do të përpunohen vetëm në automjet (komandimi offline me zë).

Të dhënat personale në lidhjen online: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), vendi depozitues nga ana e sistemit dhe pozicioni aktual i automjetit, gjuha e zgjedhur e sistemit të informimit dhe argëtimit, kodi i vendit të automjetit, kodi ID i përdoruesit, kodi rajonal dhe numri i versionit të softuerit të sistemit të informimit dhe argëtimit, gjuha e folur dhe gjuha e përgjigjes

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 30 ditësh.

Baza ligjore: për përdoruesin kryesor: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës); për përdorues të tjerë të automjetit dhe për pasagjerët e tjerë të automjetit pa kontratë, përmes SHËRBIMEVE ONLINE ME CELULAR: Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: zbatimi i kontratës për SHËRBIMET ONLINE ME CELULAR)

Marrës të tjerë të të dhënave: Cerence GmbH, Jülicher Straße 376, 52070 Aachen, Europa. (Këta marrës i përpunojnë të dhënat vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

13. Radio interneti

Në kuadër të funksionit "Radio interneti", sistemi i informimit dhe i argëtimit vë në dispozicion një katalog aktual stacionesh dhe podkastesh specifikë sipas gjuhës. Me anë të tij ekziston mundësia e dëgjimit të mijëra stacioneve dhe episodeve të podkasteve të llojeve të ndryshme nëpërmjet transmetimit online.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), adresa IP

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: e.solutions GmbH, Despag-Straße 4a, 85055 Ingolstadt, Gjermani. (Të dy marrësit i përpunojnë të dhënat personale vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona.)

14. Udhëzime për temperaturën*

Shërbimi "Udhëzimet për temperaturën" i rekomandon përdoruesit kryesor dhe përdoruesit që nëpërmjet aplikacionit të vendosë një kohë të nisjes në temperatura të jashtme të ulëta ose për ta karikuar automjetin për të shmangur një fuqi të kufizuar të baterisë të kushtëzuar nga i ftohti. Ky shërbim është në dispozicion për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin atëherë, nëse përdoruesi kryesor ka qenë i regjistruar së fundmi në automjet. Kështu bateria mund të ngrohet paraprakisht në kohën e duhur dhe në këtë mënyrë mund të përgatitet për funksionim në temperatura të jashtme të ulëta.

Për të marrë udhëzime për temperaturën nëpërmjet njoftimeve Push, duhet të jepet më parë leja në aplikacion që të dërgohen njoftimet Push.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit i automjetit (VIN), kodi ID i përdoruesit, statusi i karikimit të baterive, madhësia e baterive, temperatura e baterive, statusi i spinës së karikimit, vula e kohës së udhëtimit si dhe statusi i gatishmërisë për lëvizjen e automjetit (kuadri "fikur"/"ndezur"), vendndodhja e automjetit, temperatura e pritshme e jashtme në vendndodhjen e automjetit (sasia e të dhënave personale të përpunuara mund të reduktohet në varësi të versionit të softuerit.)

Të dhënat personale do të fshihen pas më së voni 15 vitesh.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor (për zbatimin e kontratës); për çdo përdorues tjetër të automjetit: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: ofrimi i shërbimit në automjet, sipas kontratës për përdoruesin)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

15. Plug & Charge

Funksioni "Plug & Charge" u ofron përdoruesve të automjetit mundësinë që të nisin proceset e karikimit me anë të një procesi verifikimi të automatizuar duke futur kabllon e karikimit.

Gjatë instalimit dhe çinstalimit të certifikatës së automjetit si dhe të kontratës përveç numrit të identifikimit të automjetit (VIN) përpunohen të dhëna të tjerë të përdorimit të IT (p.sh. indeksi i ruajtjes së certifikatës së kontratës ose të dhënat e transaksionit).

Në rastin e autentifikimit në stacionet publike të karikimit përpunohen të dhënat shtesë të kontratës (p.sh. numri i identifikimit të certifikatës së kontratës) dhe në këtë mënyrë mundësohet ndërprerja e seancës së karikimit nëpërmjet ofruesit të energjisë së udhëtimit.

Për autentifikimin në një Wallbox privat transferohen gjithashtu edhe të dhënat e përdorimit të IT (p.sh. numri i serisë së certifikatës së automjetit) në Wallbox privat.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), të dhënat e përdorimit të IT (p.sh. numri i serisë së certifikatës së automjetit, indeksi i ruajtjes së certifikatës së kontratës, të dhënat e transaksionit), të dhënat e kontratës (p.sh. numri i identifikimit të kontratës së rrymës së karikimit (EMAID))

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR (për zbatimin e kontratës)

Marrës të tjerë të të dhënave: nuk ka

Në kuadër të përpunimit të të dhënave nga ofruesit e energjisë së udhëtimit dhe ofruesit e Wallbox, ju lutemi të ndiqni udhëzimet e tyre për mbrojtjen e të dhënave.

16. Thirrje në rast avarie*

Thirrja në rast avarie mund të aktivizohet nga përdoruesi i automjetit në rast të një avarie (me ose pa dritë paralajmëruese të ndezur) ose në rast dëmtimesh të vogla aksidentale nën pragun e aktivizimit të sistemeve penguese të fëmijëve (siç janë jastëkët e ajrit dhe tendosësit e rripave). Nëse pajisja komanduese e jastëkut të ajrit identifikon një goditje të tillë, përdoruesit të automjetit do t'i ofrohet një lidhje audio me shërbimin për thirrjen e emergjencës ose për thirrjen në rast avarie, përmes sistemit të informimit dhe të argëtimit. Kështu do të transmetohen automatikisht të dhëna të caktuara, si për pajimin e automjetit, për të mbështetur punonjësit e Call Centers të thirrjeve në rast avarie, si dhe nëse nevojitet, kompaninë e rimorkimit, për të ofruar ndihmë shpejt dhe në mënyrë efikase. Ky shërbim nuk mbështetet aktualisht nga vendet e mëposhtme; këtu ka vetëm një njoftim të grupit: Shqipëria, Malta, Ukraina, Maqedonia e Veriut, Serbia, Qipro.

Gjithashtu ofrohet mundësia, për të njoftuar në mënyrë komode për ngjarjen në rast avarie ose për dëmin e automjetit nëpërmjet aplikacionit Volkswagen direkt te një partner i Volkswagen. Kjo mund të bëhet me anë të telefonit nëpërmjet një Callcenter ose të kryhet nëpërmjet formularit të aplikacionit.

Ne i përpunojmë të dhënat për ofrimin e shërbimit, për t'ju siguruar juve ndihmë të shpejtë në rast aksidenti ose rast avarie. Për qëllime të ofrimit të shërbimeve, importuesi ose për tregun gjerman Volkswagen Deutschland GmbH & Co. KG, i kalon të dhënat sipas kërkesës te një partner servisi dhe te kompania e sigurimit (në varësi të disponueshmërisë).

Për përmirësimin e produkteve tona dhe proceseve të biznesit, të funksionalitetit të klientëve të thirrjes në rast avarie, për optimizimin e përdorimit të klientëve, si dhe me qëllim për zgjidhjen e defekteve të produkteve, ne përpunojmë të dhënat tuaja. Ne analizojmë të dhënat tuaja me qëllim përmirësimin e produktit dhe garantimin e cilësisë së thirrjes në rast avarie dhe për shmangien e ndërprerjeve ose vonesave në ecurinë e procesit të përpunimit të kërkesave. Kështu kontrollojmë,

për shembull, nëse ka probleme në transferimin e të dhënave te partnerët tuaj të servisit (p.sh. të dhëna të paplota ose vonesa brenda dërgimit të të dhënave), për t'i identifikuar dhe për t'i ngarkuar para kohe. Kështu ne mund të ofrojmë servisin më të mirë të mundshëm të orientuar për klientin dhe të rrisim kënaqësinë e klientit me shërbimet dixhitale. Gjithashtu, do të përcillen të dhënat e specifikuara tek importuesi përgjegjës për vendin tuaj, për komandimin dhe përmirësimin e procesit, p.sh. për auditet e cilësisë.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), numri i telefonit i kartës SIM të integruar në automjet, titulli, mënyra e adresimit, emri, datëlindja, adresa, shteti, numri i telefonit, adresa e emailit, targa, të dhënat e automjetit (marka, kilometrazhi, autonomia e mbetur, emri i modelit, viti i modelit, ngjyra, kambio, lloji i transmisionit, viti i prodhimit, tipi i automjetit, shenjat dalluese të pajisjes), të dhënat e sigurimit (emri i kompanisë së sigurimit të raportuesit të aksidentit, numri i sigurimit të raportuesit të aksidentit, lloji i dëmit, emri i kompanisë kundërshtuese të sigurimit), të dhënat e rastit (zona e përplasjes, shkalla e përplasjes, dita e aksidentit, koha e aksidentit, shkaktari, dritat paralajmëruese, regjistrimet e memories së ngjarjes, të dhënat e pozicionit të automjetit, lloji i dëmtimit, data e regjistrimit të dëmit, llogaritja paraprake e dëmit, afati i ardhshëm i servisit, servisi i fundit) dhe, nëse është e nevojshme, të dhëna të tjera personale, të cilat përdoruesi i automjetit i jep gjatë telefonatës (afati i fshirjes 24 orë: vlen vetëm për të dhënat që shërbimi në rast avarie dërgon në qendrën e thirrjeve); për përpunimin e të dhënave në kuadër të analizës.

Numri i identifikimit të automjetit, kategoria e nevojës për servis, data e dërgimit të regjistrimit të të dhënave të telefonatës në rast avarie, partneri i zgjedhur i servisit dhe informacionet për datën e dakordësuar. Gjithashtu, partneri përkatës i servisit transferon të dhënat e mëposhtme: numrin e identifikimit të automjetit, kohën e pranimit, kohën e kontaktimit dhe kohën e përfundimit.

Baza ligjore: Neni 6, parag. 1, germa "b" e GDPR për përdoruesin kryesor dhe përdoruesin (për zbatimin e kontratës): neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR për çdo përdorues tjetër të automjetit duke përfshirë vizitorin (interesat legjitime: zbatimi i kontratës "VW Connect" ndaj përdoruesit kryesor); për përpunimin e të dhënave në kuadër të analizës: neni 6, parag. 1, germa "f" e GDPR (interesat legjitime: përmirësimi i produkteve dhe proceseve të biznesit, funksionaliteti i klientëve të thirrjes në rast avarie; optimizimi i përdorimit të klientëve; zgjidhja e defekteve të produkteve; komandimi dhe përmirësimi i procesit në treg; rritja e kënaqësisë së klientit me shërbimet).

Marrës të tjerë të të dhënave: Një importues (në rastin e tregut gjerman Volkswagen Deutschland GmbH & Co. KG, Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg) i kalon të dhënat për përmbushjen e një kontrate me palën e tretë ose në bazë të dhënies së pëlqimit tuaj te palë e tretë e zgjedhur në mënyrë të qartë nga ju (p.sh. kompania e sigurimit).

ARC Europe S.A., Avenue des Olympiades 2, 1140 Brüssel, Belgien ose ofruesi lokal i shërbimit i ngarkuar prej tij; nëse është i nevojshëm, një partner i servisit të Volkswagen ose një kompani rimorkimi si dhe pas miratimit kompania juaj e sigurimit.

Pa shërbimet e "VW Connect" ose nëse automjeti përdoret offline ose nëse shërbimi është çaktivizuar përmes aplikacionit, thirrja në rast avarie është gjithmonë në dispozicionin tuaj edhe offline; por megjithatë nuk kryhet asnjë transmetim automatik i të dhënave nga automjeti në Call-Center.

17. Raporti i gjendjes së automjetit

Disponueshmëria varet nga versioni i softuerit

"Raporti i gjendjes së automjetit" e informon përdoruesin kryesor dhe përdoruesin për gjendjen aktuale të automjetit. Përveç kësaj, përdoruesi kryesor dhe përdoruesi mund të shfaqin njoftimet

paralajmëruese të zgjedhura të automjetit dhe/ose një nevojë të mundshme për servis në fushën e tyre personale të hyrjes në shfletuesin e internetit dhe të aplikacionit. Vendimtare janë vetëm njoftimet paralajmëruese dhe të defekteve në automjet.

Të dhënat personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), kilometrazhi, koha deri në mirëmbajtjen e ardhshme, njoftimet paralajmëruese

